Kronikë

Durrës/ 2 të arrestuar pas sherrit dhe të shtënave me armë në lagjen 15! Në kërkim një tjetër

Lidhur me ngjarjen e mbrëmshme në Durrës, ku një 29 vjeçar qëlloi me armë në ajër pranë një lokali në lagjen 15, janë arrestuar dy persona. Ndërkohë në kërkim është një i tretë.

■ Të shtëna me armë 'Shotgun' në Durrës, s'ka të lënduar! Shkak sherri mes dy personave të dehur në lokal, Policia shoqëron autorin (VIDEO)

Vendngjarja në Durrës

Redaksia
26 Dhjetor, 10:42 | **Përditesimi: 26 Dhjetor, 11:01**

Share

DURRËS - Dy persona janë vënë në pranga sa i përket ngjarjes së djeshme në lagjen nr.15 në Durrës, ku një 29 vjeçar qëlloi me armë gjahu në ajër, në gjendje të dehur në një lokal. Siç bën me dije policia 29 vjeçari, K.D., është njëri prej të arrestuarve.

Më tej dinamika e ngjarjes ishte e tillë, teksa 2 persona në lokal goditën me sende të forta 29 vjeçarin, dyshohet për motive të dobëta. Ata janë P.P., 26 vjeç , pronari i lokalit dhe kushëriri i tij D.P., 35 vjeç, i cili është shpallur në kërkim.

> *'Si rezultat i veprimeve hetimore dhe procedurale, të kryera menjëherë pas konfliktit, u arrestuan në flagrancë shtetasit K. D., 29 vjeç dhe P. P., 26 vjeç, të dy banues në Durrës. Gjithashtu, u shpall në kërkim kushëriri i shtetasit P. P., shtetasi D. P., 35 vjeç, banues në Durrës.', njofton policia.*

[Sh].com

LEXO EDHE:
Eduard Zaloshnja: Gjykata kushtetuese vs. realiteti elektoral

Pas goditjes me sende të forta, 29 vjeçari ka shkuar në banesë dhe mori një armë gjahu, që e kishte pa leje dhe kanosi me të dy shtetasit që e rrahën më parë.

> *'Shtetasi P. P. dhe D. P., dyshohet se për motive të dobëta, kanë goditur me sende të forta, 29-vjeçarin, në lokalin që administronte shtetasi P. P.. Më pas dyshohet se duke qenë në gjendje të dehur, shtetasi K. D. ka shkuar në banesën e tij, ku mbante pa leje, një armë gjahu, me të cilën ka qëlluar në ajër, me qëllim kanosjen e 2 shtetasve.', vijon më tej njoftimi i policisë.*

Policia arrestoi atë dhe 26 vjeçarin P.P., ndërsa po punohet për kapjen e D.P.

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: kanosje me arme | kanosje | Durres

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM
Sondazhi i ditës:
26 Dhjetor, 08:05
Si ka qenë për ju viti 2024?
I mirë | I keq | As i mirë as i keq

Lajme të tjera

Të shtëna me armë 'Shotgun' në Durrës, s'ka të lënduar! Shkak sherri mes dy personave të dehur në lokal, Policia shoqëron autorin (VIDEO)
25 Dhjetor, 18:28

Pushimet e shqiptarëve për festat e fundvitit, agjentja turistike për Report Tv: Vjena e Budapesti të preferuara! Egjipti më i vizituari këtë vit
25 Dhjetor, 15:50

Kremtohet Krishtlindja në Durrës, besimtarët e krisherë luten për paqe dhe mirësi
25 Dhjetor, 10:27

Durrës/ Kamioni përplas për vdekje 40-vjeçarin me biçikletë në rrugë, shoferi arratiset nga vendngjarja! Bllokohet mjeti, identifikohet viktima (VIDEO+FOTO)
24 Dhjetor, 17:32

Miratohet buxheti i bashkisë së Durrësit për 2025/ Anëtari i PD-së del nga rreshti, ja çfarë parashikon
Aldo Mustafa
24 Dhjetor, 16:34

Porti i Durrësit, rinis udhëtimi i trageteve
24 Dhjetor, 13:08

Moti i keq në Durrës, ishte ankoruar në portin e peshkimit, fundoset peshkarexha 'Gimi dhe Geri'
23 Dhjetor, 14:40

Moti i keq/ Pezullohet lundrimi i trageteve Durrës-Bari e anasjelltas, në Vlorë trageti mbetet në radë! Rruga e Arbrit e pakalueshme
23 Dhjetor, 13:45

VIDEOLAJM/ Dy tragete përplasen në kalatën e portit të Durrësit, shkak moti i keq! S'ka të plagosur
23 Dhjetor, 13:01

E përditshmja britanike 'Sunday Times': 10 vendet më të mira për t'u vizituar në Shqipëri
23 Dhjetor, 09:52

Krujë/ U denoncua i zhdukur nga familjarët, gjendet pas 23 ditësh pa jetë 57-vjeçari Edmond Veseli
Julian Shota
22 Dhjetor, 16:08

Nata e ndërrimit të viteve në Durrës, bullgarët e polakët kryesojnë rezervimet në hotele! Operatori turistik: Çmimet u rritën me 10%
Aldo Mustafa
21 Dhjetor, 11:37

HOROSKOPI
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje